



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

VENDIM

NR. 31, Datë 30.04:2024

“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR Z. NIKOLLA LLAMBRO

Në kuadër të vlerësimit të figurës së Z. Nikolla Llambro, si dhe në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit", V.K.M Nr. 861, datë 10/12/2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit", Këshilli i Bashkisë i mbledhur në datën 30.042024, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, për dhënie titulli "Qytetar Nderi" për Z. Nikolla Llambro, si dhe mbështetur në relacionin e Komisionit Vendor për Dhënien e Titujve të Nderit,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për z. Nikolla Llambro me motivacionin:

“Për kontribut të shquar intelektual dhe artistik në Teatrin “Zihni Sako” Gjirokastrë dhe në kinematografinë shqiptare, si aktor me dimesione të spikatura kombëtare e ballkanike, personalitet i botës shqiptare dhe urë lidhëse miqësie e integrimi për qindra dhe mijëra emigrantë shqiptarë që punojnë e jetojnë në Greqi”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ